



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurrenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.75/23
Data: 07.08.2023

Në bazë të neni 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27,34,35,39 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 29.06.2023, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, përmes Përfaqësuesve ligjor z. Sokol Elmazaj dhe Znj. Delvina Nallbani lidhur me shitblerjen e aksioneve dhe marrjen e kontrollit në mes të ndërmarrjeve Wintergate International SE (blerës), i cili do të blej 40% të aksioneve të Bonak a.s (shitës), mbi Titancon dhe Vivanttis, (targeti).

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 07.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve: lidhur me marrjen e kontrollit nga Wintergate International SE (blerës), Bonak a.s., (shitës) mbi Titancoin International a.s., dhe Vivantis a.s., (Targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (tre mijë) Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë; 29.06.2023, me Nr. Prot. 297/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të Bonak a,s, që i cili do të blej 40% të aksioneve dhe të drejtat e votës nga Wintergate International SE.

Palët në Përqendrim

Bonak a.s., është shoqëri aksionare Çeke, me seli në Evropská 2690/17, Dejvice, 160 00 Pragë 6, me numër identifikimi 050 98 815, e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Gjykata Komunale në Pragë, Dosja nr. B 21592.

Wintergate International SE, një Societas Europea Çeke, më zyrën e saj të regjistruar në Evropská 2758/II, Dejvice, 160 00 Pragë 6, me numër identifikimi 067 81 632 e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Gjykata Komunale në Pragë, Dosja nr. H 2075.

Titancoin International a.s., është shoqëri aksionare me numri të biznesit: 073 22 437 me adresë Evropská 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6 Republika Çeke. Titancoin nuk ka asnjë aktivitet biznesi, megjithatë ajo zotëron 100% të aksioneve në VIVANTIS a.s.

Vivantis a.s., është shoqëri aksionare çeke, e cila ka zyrën e saj të regjistruar në Školní náměstí 14, 537 01 Chrudim, Republika Çeke, e regjistruar në regjistrin tregtar Çekë me numër identifikimi 259 77 687 ("Vivantis ") (Titancoin dhe Vivantis së bashku ("Kompania e synuar"). Vivantis operon në e-dyqane të ndryshme aktive kryesisht në Republikën Çeke, Sllovaki, Rumani, Hungari, Austri dhe Itali duke u fokusuar kryesisht në kozmetikë, parfume, modë, orë dhe bizhuteri, elektronikë (veçanërisht elektronikë të konsumit dhe pajisje të vogla shtëpiake) dhe kujdesin për fëmijë.

Baza Ligjore

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumë 20,000,000 Euro.
 - b) Qarkullimi i një pale në tregun e brendshëm e kalon shumë 1,000,000 Euro.
 - c) Wintergate International SE, blerjen e aksioneve 40% të BONAK a.s.,
- Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye **Wintergate** ka shitje në Kosovë përmes ndërmarrjeve:

Gjirafa Kosova LL.C, me numër të biznesit 810123860, me adresë në Graçanicë
Gjirafa, Inc, dega në Kosovë, me numër të biznesit 810840307, me adresë në Graçanicë
Trekandi SH.P.K me numër të biznesit 810046757, me adresë në Graçanicë

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, të paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11, 13, 17, 18, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 18.07.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 19. 07. 2023
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen e lidhur me datë 24. 05. 2023, ndërmjet Wintergate International SE dhe Bonak a.s.

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar, nuk do të kufizoi apo shtrëmbëroj konkurrencën në tregun e Kosovës, e as nuk do të shkaktojë efekte negative tek konsumatorët në tregun përkatës, pasi që pjesmarrësit në përqendrim veprojnë në tregun e Çekis ndërsa tregu i Kosovës mbetet i paprekur. Transaksioni i propozuar nuk mund të forcojë asnjë pozitë dominues në treg, pasi që Ndërmarrja e Synuar

(Vivantis) operon në e-dyqane të ndryshme aktive kryesisht në Republikën Çeke, Sllovaki, Rumani, Hungari, Austri dhe Itali.

Tregu Relevant: Ndërmarrjet edhe pas transaksionit nuk do ta ndryshoj strukturën e tyre tregun përkatës në Republikën e Kosovës.

Tregu i produktit – Shitja me pakicë në internet e mallrave të konsumit dhe jo të konsumit si dhe një masë e pa papërfillshme e shitjeve me shumicë e shëndetit dhe bukurisë, veshjeve, këpucëve, orëve dhe bizhuterisë.

Tregu gjeografik – transaksioni do të kryhet në Republikën Çeke, por meqenëse shitja me pakicë (online) e produkteve të konsumit është prezent në Kosovë, atëherë tregu gjeografik, konsiderohet Republika e Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republike Çeke, kërkesa për Njoftim të Përqendrimit, është bërë për arsye se palët në përqendrim, ndërmarrja Wintergate është pjesë e Rackaway Group, e cila është e pranishme në Kosovë përmes Grupit Gjirafa, e që kontrollohet bashkërisht nga Rockaway dhe dy palë të tjera të përbashkëta kontrollues. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, sepse transaksioni i propozuar nuk çon në ndonjë mbivendosje horizontale ose lidhje vertikale dhe si rrjedhojë nuk krijonë ndonjë shqetësim për konsumatorët në Kosovë, d.m.th transaksioni nuk do të ndryshojë tregun dhe asnjë marrëdhënie vertikale. Kushtet e konkurrencës do të mbesin të njëjta si para transaksionit dhe pas transaksionit. Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg Kosovar.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv, të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURENCËS I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva